

PERMBLEDHJE
HIV/AIDS NË SHQIPËRI



INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
2024

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE


Ky informacion paraqet situatën e infeksionit HIV në Shqipëri, bazuar në të dhënat e raportuara deri në fund të Tetorit të vitit 2024.

Të dhënat ekzistuese dëshmojnë se në Shqipëri nuk ka epidemi të gjeneralizuar apo të përqendruar të infeksionit HIV. Në periudhën 2010-2023 numri vjetor i rasteve të raportuara me HIV u rrit më shumë se 2 herë në krahasim me numrin e raportuar para vitit 2010 (më pak se 50 raste), duke arritur deri në 127 raste apo 4.5 raste/100.000 banorë, që ishte dhe niveli më i lartë në vitin 2016.

Numri i rasteve të reja të diagnostikuara në vitin 2024 (deri në fund të muajit Tetor) është 119, ndersa referuar të dhënave kumulative, gjatë periudhës 1993-Tetor 2024, numri total i rasteve të raportuara me HIV/AIDS është 1844.

Në Tetor të vitit 2024, prevalenca e infeksionit vlerësohet të jetë me 0,076%, ndërsa incidenca (rastet e reja në 2024) 4.95 për 100,000 banorë (popullsia sipas Census 2023).

Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve me HIV në vite, 1993- Tetor 2024




Rruga seksuale e transmetimit të virusit HIV vazhdon të dominojë në vendin tonë, e cila konstatohet në 95% të rasteve. Sipas të dhënave kumulative transmetimi nëpërmjet marrëdhënieve heteroseksuale përbën 71.6% të rasteve, ndërkohë që mënyra e transmetimit nëpërmjet marrëdhënieve seksuale midis meshkujve haset në 23.5 % të rasteve.

Ndonëse mënyra mbizotëruese e transmetimit raportohet ajo heteroseksuale, fakti që pothuajse tre të katërtat e rasteve me HIV janë meshkuj, si dhe fakti që ekziston një numër relativisht i lartë i çifteve sero-diskordante tregon se transmetimi te popullata e MSM ka gjasa të raportohet nën nivelin real - ndoshta për shkak të stigmës së fortë dhe diskriminimit ndaj MSM.

Transmetimi vertikal ose nga nëna e infektuar me HIV te fëmija përbën 2.5 % të totalit (46 raste), 0.6% i përkasin rasteve të transmetimit nepermjet gjakut apo nenprodukteve të tij; 0.8% e rasteve i përkasin grupit të Personave që Injektojnë Drogë dhe në 1 % të numrit total të rasteve pozitive, nuk ka informacion në lidhje me rrugën e transmetimit .


Për vitin 2024, niveli i incidences (rastet e reja të diagnostikuara) të meshkujt është 7.5 për 100.000 dhe për femrat 2.5 për 100.000. Në rastet e diagnostikuara në vitin 2024, numri më i madh konstatohet të meshkujt e grupmoshës 30-39 vjeç dhe 40-49 vjeç ndërsa të femrat në grupmoshën >50 vjeç (grafiku 2).

Grafiku 2. Rastet e reja (2024) sipas gjinise dhe grupmoshes




Ashtu si dhe në vitet e mëparshme, më shumë meshkuj se femra u diagnostikuan me HIV në vitin 2024 (89 dhe 30, respektivisht), duke rezultuar në një raport meshkuj-femra 3:1. Në total (1993-2024), 73 % (1339 raste) janë meshkuj dhe 27 % (505 raste) janë femra (grafiku 3).

Grafiku 3. Shpërndarja e rasteve me HIV në përqindje, sipas gjinisë në vite (2010-2024)



Shpërndarja sipas grupmoshave tregon se në vendin tonë predominon grupmosha 35-44 vjec (27.9%), e ndjekur nga grupmosha 25-34 vjec (26.8%). Grupmosha 45-54 vjeç raportohet 18 %, të rinjtë 16-24 vjeç përbëjnë 9.7%, 55-64 vjec përbën 11.1% të totalit të rasteve të infektuara me HIV, ndërsa fëmijët (0-15 vjec) përbëjnë 3%. Një përqindje më të ulët paraqet grupmosha mbi 65 vjec në vlerën 3% (grafiku 4).


Grafiku 4 . Shpërndarja totale e rasteve me HIV sipas grup-moshave, (1993- Tetor 2024)



Nga rastet e raportuara në vitin 2024, pothuajse një e dyta e rasteve pozitive (49%) vijnë si rekomandime, kryesisht nga Shërbimi i Sëmundjeve Infektive në QSUT duke përfshirë edhe spitale privatë; 15.1% i përkasin testeve vullnetare që vijnë në shërbimet e keshillimit dhe testimit për HIV (VCT); 10.9% nga ndjekja epidemiologjike që kryhet për partnerin/partneren ose për fëmijën e diagnostikuar pozitiv; 5.9% nga testimi i dhuruesve të gjakut; 4.2% nga testimet që

kryjnë OJQ që ofrojnë shërbime për grupet me risk; 2.5% për arsye të tjera (testime para procedurave mjekësore dhe 0.8% për dokumentacion) dhe 1.7% i përkasin kategorisë gra shtatzëna

Grafiku 5. Shpërndarja (në përqindje) e rasteve të reja pozitive në 2024 sipas arsyes së testimit.



Diagnoza e hershme është shumë e rëndësishme në ecurinë e infeksionit HIV dhe suksesin e mjekimit me Antiretrovirale (TAR). Diagnostikimi i vonshëm vazhdon të mbetet sërish një problem që paraqitet edhe me numrin e madh të rasteve që raportohen në stadin AIDS.

Edhe gjatë vitit 2024, personat e diagnostikuar me HIV kanë patur akses të plotë gjatë gjithë vitit për kryerjen e vlerësimit imunologjik, si një nga treguesit kryesore të monitorimit të infeksionit HIV. Kjo analizë kryhet pranë shërbimit të imunologjise në QSUT.

Nga rastet e regjistruara për herë të parë deri në fund të Tetorit 2024, 98 prej tyre ose 93% e tyre kanë kryer testin për matjen e CD4 (mungon kjo e dhënë për raste e diagnostikuar jashtë shtetit)

Të dhënat tregojnë se 68 paciente ose 64.3 % e pacientëve të rinj që kanë kryer testin e CD4 kanë paraqitur CD4 më të ulët se 350, çka flet për një diagnozë të vonë të infeksionit HIV, 38 paciente ose 38.8% e rasteve që kanë kryer CD4 janë raportuar në një stad shumë të vonë të infeksionit ($CD4 < 200$); 17.3% (17 paciente) raportohen të kenë një CD4 në vlerat 350-500 dhe 18 paciente ose 18.4% raportohen me një $CD4 > 500$.

Grupi i pacientëve me diagnoze të vonë dhe shumë të vonë, mund të kenë qenë të infektuar prej vitesh pa shfaqur simptoma. Efekti i mundshëm multiplikues i kësaj situatë, po të kemi parasysh se secili person mund të ketë pasur disa partnerë është shumë i rëndësishëm, dhe hedh dritë absolutisht mbi diagnostikimin e infeksionit në fazat e hershme të tij. Bazuar në klasifikimin e

CDC-së për AIDS (kriteri klinik dhe imunologjik), 43 raste ose 41% nga rastet e regjistruara në kujdesin për HIV në vitin 2024 janë në stadin AIDS.

Përqindja e personave që janë rregjistruar për herë të parë në kujdes dhe që janë diagnostikuar në një stad të vonë ($CD4 < 350$) varion sipas grupmoshës dhe gjinisë, ku numri më i lartë vërehet te meshkujt dhe te grupmosha + 50 vjec.

Numri i personave HIV pozitiv që nuk jetojnë nga diagnostikimi i rastit të parë e deri në Tetor të vitit 2024, është 358.

HIV/AIDS mbetet një fenomen akoma urban në vendin tonë pasi shumica e personave janë me vendbanim në qytet. Numri më i madh i rasteve ose 48.4 % e tyre janë raportuar me vendbanim në Tiranë, më pas me një diferencë të madhe nga Tirana paraqiten rrethet e tilla si Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Lushnjë, Fier, Korce, Sarandë etj